




Periodik mujor Nr. 191 Prill 2025

Në këtë periodik do të lexoni:

Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit, pjesë e delegacionit shqiptar në hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian për grup-kapitullin e dytë



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Mars 2025

Zhvillimet e tregut të Titujve të Qeverisë jashtë Bursës,
Janar-Mars 2025

4-5

ZHVILLIME TË TJERA 6-7

BOTIME PROFESIONALE

8-12

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

13-15

Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit, pjesë e delegacionit shqiptar në hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian për grup-kapitullin e dytë



Hapen zyrtarisht negociatat për grup-kapitullin e dytë “Tregu i brendshëm”,

Më 14 prill, në Luxemburg u mbajt Konferenca e katërt Ndërqeveritare Shqipëri – BE ku u hapën zyrtarisht negociatat për grup-kapitullin e dytë “Tregu i brendshëm”, duke shënuar një tjetër hap përpara në procesin e integritimit evropian të vendit. Në këtë ngjarje me rëndësi historike, delegacioni shqiptar u kryesua nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama. Pjesë e delegacionit ishte edhe Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF, znj. Mimoza Kaçi, në cilësinë e negociatores së kapitullit 9 “Shërbimet financiare”.

Autoriteti është përfshirë në një proces intensiv përafrimi të kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit financiar me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian dhe është i përkushtuar në përmbushjen e të gjitha angazhimeve të marra në kuadër të këtij kapitulli.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Mars 2025


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për Janar-Mars 2025 kapën vlerën 5,598 milionë lekë, ose 7.09% më shumë se në Janar-Mars 2024. Gjatë Janar-Shkurtit 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 347,838 me një rritje prej 11.90% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.45% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.48% dhe risigurimi me 0.071% . Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.56% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.44% të totalit të tregut.

Gjatë Janar-Mars 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,921 milionë lekë, ose 3.77% më pak se në Janar-Mars 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për Janar-Mars 2025 kapën vlerën 1,203 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 5.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Mars 2025 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë Janar-Marsit 2025 arritën rreth 3,384 milionë lekë, ose 12.18% më shumë se në Janar-Mars in 2024.

Zhvillimet e tregut të Titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën Janar-Mars 2025

Të dhënat statistikore të tregut të titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar-mars 2025, flasin për një dominim të transaksioneve “Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 54.83% dhe 37.15% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë të realizuara jashtë Burse për periudhën janar-mars 2025, u dominua në masën 64.29% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 35.71% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 76.80% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari. Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar-mars 2025 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.08% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tre grupet e transaksioneve B, C dhe F

- Transaksioni i llojit B “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere)” gjatë periudhës janar-mars 2025, ka pasur një rritje prej 46 milionë lekë ose 3.05% krahasuar me periudhën janar-mars 2024. Ndërkohë, numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 46.96%.
- Transaksioni i llojit C “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori)” gjatë periudhës janar-mars 2025, ka pasur një rritje prej 395 milionë lekë ose 74.18%, gjithashtu me një rritje prej 24.69% në numrin e transaksioneve, krahasuar me periudhën janar-mars 2024.
- Transaksioni i llojit F “Ekzekutimi i urdhrat të klientit (jo nga dhe për llogari të portofolit të subjektit)” gjatë periudhës janar-mars 2025, ka pasur një rritje prej 657 milionë lekë ose 32,828%, gjithashtu me një rritje prej 2,900% në numrin e transaksioneve, krahasuar me periudhën janar-mars 2024.

Në totalin e transaksioneve të llojit B, C dhe F të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 1,098 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2024.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar-mars 2025 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 97.08% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon leksion të hapur me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një leksion të hapur me studentët e Fakultetit të Biznesit, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ekspertë të Autoritetit njohën pjesëmarrësit me rolin e Autoritetit, si mbikëqyrës dhe rregullator i tregjeve financiare jobankare.

Leksioni kishte si qëllim kryesor ndërgjegjësimin dhe rritjen e njohurive financiare të studentëve, duke u fokusuar në konceptet bazë të tregut të sigurimeve, si dhe nevojën për sigurim, si një mekanizëm i transferimit të rrezikut dhe mundësi investimi. Gjatë diskutimeve interaktive me studentët, pati interes të lartë për çështjet e trajtuara. Gjithashtu, ata vlerësuan të rëndësishme informacionet dhe publikimet në faqen zyrtare të Autoritetit, si burim zyrtar informacioni për projektet dhe punimet e tyre.

Zhvillimi i leksionit të hapur është pjesë e aktiviteteve që Autoriteti po zhvillon në kuadër të strategjisë për edukim dhe përfshirje financiare.



Leksioni kishte si qëllim kryesor rritjen e njohurive financiare të studentëve, duke u fokusuar në konceptet bazë të tregut të sigurimeve, si dhe nevojën për sigurim, si një mekanizëm i transferimit të rrezikut dhe mundësi investimi.

Lehtësohet lëvizja e autoveturave me targa shqiptare drejt vendeve kufitare, anëtare të CEFTA-s

1. CERTIFIKATË NËRKOMBËTARE E SIGURIMIT MOTODRIK INTERNACIONAL MOTOR INSURANCE CARD CARTE INTERNATIONALE D'ASSURANCE AUTOMOBILE			2. LËSHUAR ME AUTORIZIM TË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT / ISSUED UNDER THE AUTHORITY OF ALBANIAN INSURANCE BUREAU																																																														
3. NGA / FROM			VLEFISHMËRIA / VALID																																																														
DERI / TO			4. Kodi i Vendi / Kodi i Sigurimit / Numri i serisë dhe i Policës së Sigurimit Country Code / Insurer's Code / Serial and Policy Numbers																																																														
Dita / Day	Muaj / Month	Viti / Year	Dita / Day	Muaj / Month	Viti / Year																																																												
(Të dyja datat e përfshira / Both dates inclusive)																																																																	
5. Targa / Registration No.			No. 25																																																														
Nr. i Shasisë ose Motorit / Chassis Engine No.			6. Kategoria e Mjetit / Category of Vehicle		7. Marka e Mjetit / Make of Vehicle																																																												
8. VLEFISHMËRIA TERRITORIALE / TERRITORIAL VALIDITY																																																																	
<table style="width: 100%; text-align: center; border-collapse: collapse;"> <tr> <td>AL</td><td>BA</td><td>BE</td><td>BG</td><td>CH</td><td>CY</td><td>CZ</td><td>DK</td><td>EE</td><td>ES</td><td>FI</td><td>FR</td> </tr> <tr> <td>GR</td><td>HR</td><td>HR</td><td>IE</td><td>IRL</td><td>IS</td><td>IT</td><td>LU</td><td>LT</td><td>LV</td><td>MT</td><td>NL</td> </tr> <tr> <td>NO</td><td>PL</td><td>PL</td><td>RO</td><td>SK</td><td>SI</td><td>SK</td><td>DK</td><td>AL</td><td>AND</td><td>AR</td><td>AT</td> </tr> <tr> <td>BH</td><td>BY</td><td>BY</td><td>MA</td><td>MD</td><td>MK</td><td>MNE</td><td>RUS</td><td>SRB</td><td>TR</td><td>TR</td><td>TR</td> </tr> <tr> <td>UA</td><td>UK</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td> </tr> </table>						AL	BA	BE	BG	CH	CY	CZ	DK	EE	ES	FI	FR	GR	HR	HR	IE	IRL	IS	IT	LU	LT	LV	MT	NL	NO	PL	PL	RO	SK	SI	SK	DK	AL	AND	AR	AT	BH	BY	BY	MA	MD	MK	MNE	RUS	SRB	TR	TR	TR	UA	UK										
AL	BA	BE	BG	CH	CY	CZ	DK	EE	ES	FI	FR																																																						
GR	HR	HR	IE	IRL	IS	IT	LU	LT	LV	MT	NL																																																						
NO	PL	PL	RO	SK	SI	SK	DK	AL	AND	AR	AT																																																						
BH	BY	BY	MA	MD	MK	MNE	RUS	SRB	TR	TR	TR																																																						
UA	UK																																																																
Ky Karton nuk është i vlefshëm në vendet ku kutia respektive është me kryq. Në përmeandur këtu, përgjegjësinë e një Siguruesi në përputhje me ligjet e sigurimit (1) Mbulimi i dhënë nga Kartonat Jeshil të lëshuar për Cipro, kufizohet në ato q (2) Mbulimi i dhënë nga Kartonat Jeshil të lëshuar për Azerbajxhan, kufizohet në ato q (3) Mbulimi i dhënë nga Kartonat Jeshil të lëshuar për Serbinë, kufizohet në ato q This Card is valid in countries for which the relevant box is not crossed out (for guarantees, in respect of the use of the vehicle referred to herein, the insurance (1) The cover provided Green Card issued for Cyprus is restricted to those g (2) The cover provided Green Card issued for Azerbaijan is restricted to those g (3) The cover provided Green Card issued for Serbia is restricted to those g 																																																																	

Bazuar në vendimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS), qytetarët shqiptarë mund të pajisen tashmë në të gjitha pikat e shitjes së shoqërive të sigurimit me policën e sigurimit “Karton Jeshil” për autovetura me vlefshmëri 12-mujore, me çmim 50 Euro, e cila mbulon territorin e Maqedonisë së Veriut.


Duke filluar nga data 1 Prill 2025, qytetarët shqiptarë do të kenë mundësinë të lëvizin drejt Maqedonisë së Veriut me policën e sigurimit “Karton Jeshil” me afat 1-vjeçar, me çmim të reduktuar prej 50 Euro. Kjo është masa e dytë që ndërmerret në një hark të shkurtër kohor, për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve shqiptarë drejt vendeve kufitare, pas hyrjes në fuqi më 1 Shkurt 2025 të policës së sigurimit “Karton Jeshil” 1-vjeçar me Malin e Zi.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) për lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare, ka bashkëpunuar ngushtë me Byronë Shqiptare të Sigurimit (BSHS), për të lehtësuar lëvizjen e autoveturave me targa shqiptare drejt vendeve kufitare.

Bazuar në vendimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS), qytetarët shqiptarë mund të pajisen tashmë në të gjitha pikat e shitjes së shoqërive të sigurimit me policën e sigurimit “Karton Jeshil” për autovetura me vlefshmëri 12-mujore, me çmim 50 Euro, e cila mbulon territorin e Maqedonisë së Veriut. Ky vendim mbështet lëvizjen e qytetarëve duke ulur kostot dhe nxitur shkëmbimet ekonomike me fqinj të juglindor. Shoqëritë e sigurimit do të ofrojnë në të gjitha pikat e shitjes policën e sigurimit “Karton Jeshil” për autovetura me afat vlefshmërie 1-vjeçar për Maqedoninë e Veriut, për Malin e Zi, si dhe do të vijojnë të ofrojnë edhe “Kartonin Jeshil” me afat vlefshmërie 15-ditor me çmim 15 euro.

“Kartoni Jeshil” është një dokument sigurimi ndërkombëtar, që mbulon përgjegjësinë e drejtuesve të mjeteve me targa shqiptare në rast aksidenti gjatë qarkullimit jashtë territorit të vendit.

IOSCO lançon portalin e ri të njoftimeve për të ndihmuar në luftën ndaj mashtrimit në investimet me pakicë



I-SCAN
International Securities & Commodities Alerts Network (I-SCAN)

IOSCO receives alerts and warnings from its members about firms which are not authorized to provide investment services in the jurisdiction which issued the alert or warning. Some of the alerts or warnings are about unauthorized firms using names similar to those of authorized firms or about unauthorized firms falsely claiming to be associated with authorized firms.

The alerts and warnings included in the below list are provided by IOSCO members on a voluntary basis. The contents of the alerts and warnings are the responsibility of the IOSCO member which issues them. This is not a complete list of all alerts and warnings from all IOSCO members.

The date next to the name of the IOSCO member is the date when the alert or warning was posted on this list.

Filter Import to CSV

Showing 1 to 20 of 3034 results

Commercial Name	Corporate Name	URL	Regulator	Date	
Cryptosuper		https://www.cryptosuper.io	Quebec - Autorité des marchés financiers	2025-05-02	View More
Fibovest		https://fibovest.com	Quebec - Autorité des marchés financiers	2025-05-02	View More
X-Rchain Limited		https://www.xrchainlimited.com	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Legitoptortrade			United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
EXODUS TRADING AI		https://exodus trading ai.net/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
BelonxTrader		https://belonxtraderai.net/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Global-digital-asset			United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Aurflux Invest		https://aurfluxinvest.net/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Trade Ais Pro		https://tradeaisproai.net/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Omanetix Trade		https://omanetixtradeai.net/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
VIVIENNETRADING/vivienetradingklass		https://vivienetradingklass.pro/	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More
Elite Trading Platform		elitetradingplatform.online	United Kingdom - Financial Conduct Authority	2025-05-02	View More

IOSCO prezantoi në Mars 2024 portalin e tij të ri të njoftimeve për investitorët, një platformë e dedikuar për të ndihmuar në luftën ndaj mashtrimit në investimet në nivel global.

Rrjeti Ndërkombëtar i Alarmeve për Letrat me Vlerë (I-SCAN) është një sistem unik global paralajmërimi ku çdo investitor, ofrues platforme online, bankë ose institucion mund të kontrollojë nëse një aktivitet i dyshimtë është raportuar për një kompani të caktuar nga rregullatorët financiarë në mbarë botën. Prezantimi i I-SCAN është pjesë e Udhërrëfyesit të IOSCO-s për Sigurinë Online të Investitorëve me Pakicë, një iniciativë e cila u lançua në nëntor të vitit të kaluar dhe e cila ka pesë valë aktiviteti.

Katër Raporte Konsultimi janë publikuar tashmë duke iu drejtuar Finfluencerëve (influencuesve financiarë), Tregtimit të Kopjuar, Praktikave të Angazhimit Dixhital dhe Neo-Ndërmjetësve. Lançimi i I-SCAN shënon aktivitetin më të fundit nën Valën e Dytë të kësaj fushate.

Sipas IOSCO, mashtrimi në investime nuk tregon shenja rënjeje. Miliarda humbasin çdo vit për shkak të aktivitetit ose deklaratave mashtruese dhe kjo tregon se nevoja për kujdesin e duhur gjatë marrjes së vendimeve për investime nuk ka qenë kurrë më e madhe.

I-SCAN u mundëson investitorëve dhe palëve të interesuara të identifikojnë, në një vend, firmat ose investimet e mundshme që janë raportuar si të palicencuara ose si mashtrim në vendin e tyre ose diku tjetër në botë, duke shpëtuar potencialisht nga mashtrimi.

vijon ...

Informacioni gjendet në:

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS763.pdf>

IOSCO lançon portalin e ri të njoftimeve për të ndihmuar në luftimin e mashtrimit me investimet me pakicë



... vijon

Rregullatorët financiarë do të dërgojnë njoftime direkt në I-SCAN duke e bërë informacionin të disponueshëm për të gjithë përdoruesit dhe investitorët, kudo në botë.

Rodrigo Buenaventura, Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s, tha: “Qendra jonë e re e centralizuar, e cila do të mbledhë alarme nga mbi 150 rregullatorë në mbarë botën, është një mundësues kritik i objektivit të IOSCO-s për të rritur mbrojtjen e investitorëve. I-SCAN do të ndihmojë anëtarët tanë në aktivitetet e tyre të zbatimit dhe ofruesit e shërbimeve online në adresimin e dëmeve online për mbrojtjen e investitorëve me pakicë.”

Derville Rowland, Zëvendësguvernator në Bankën Qendrore të Irlandës dhe Kryetar i Grupit të Koordinimit të Investitorëve me Pakicë i ngarkuar me mbikëqyrjen e kësaj pune në IOSCO, shtoi: “Jam i kënaqur që shoh lançimin e I-SCAN, i cili është iniciativa më e fundit në fushatën tonë për të përmirësuar sigurinë online të investitorëve me pakicë. Me mashtrimet që vazhdojnë të jenë në rritje, është shumë e rëndësishme që investitorët të kontrollojnë dy herë investimin e tyre. I-SCAN është një hap thelbësor në çdo vendim financiar.”

Informacioni gjendet në:

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS763.pdf>

IAIS – Një pasqyrë e zhvillimeve gjatë vitit 2024



Informacioni gjendet
në:


<https://www.iais.org/2025/04/iais-year-in-review-2024/>



Botimi “Pasqyra e zhvillimeve për vitit 2024” e IAIS paraqet aktivitetet dhe arritjet gjatë vitit të kaluar.

Viti 2024 shënoi 30-vjetorin e IAIS. Gjatë këtyre tre dekadave, IAIS ka evoluar nga një forum mbikëqyrësish, në organin global të përcaktimit të standardeve për mbikëqyrjen e sigurimeve, pjesë integrale e arkitekturës financiare globale. Raporti ofron një pasqyrë të përgjithshme të misionit, strategjisë dhe rolit të IAIS në arkitekturën globale të mbikëqyrjes financiare. Ai ndan progresin dhe arritjet kryesore të komiteteve, grupeve të punës dhe forumeve të IAIS në vitin 2024. Raporti ofron gjithashtu një pasqyrë të përgjithshme të Planit të ri Strategjik 2025-2029.

IAIS publikon Dokumentin gjithëpërfshirës të Aplikimit mbi mbikëqyrjen e rreziqeve që lidhen me klimën në sektorin e sigurimeve



- Dokumenti i Aplikimit ofron një informacionin se si Parimet Themelore të Sigurimeve (ICP) ekzistuese të IAIS mund të zbatohen për të adresuar rreziqet që lidhen me klimën;
- IAIS do të vazhdojë të mbështesë anëtarët e saj me materiale praktike dhe seanca për ndarjen e njohurive për të ndihmuar në adresimin e rreziqeve që lidhen me klimën brenda kornizave mbikëqyrëse.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) publikoi sot Dokumentin e saj të Aplikimit mbi mbikëqyrjen e rreziqeve që lidhen me klimën në sektorin e sigurimeve, pas katër konsultimeve dhe angazhimit të gjerë të anëtarëve dhe palëve të interesuara.

Rreziqet që lidhen me klimën, duke përfshirë ngjarjet ekstreme të motit, po ndikojnë gjithnjë e më shumë te konsumatorët dhe bizneset, duke theksuar qëllimin kryesor shoqëror të sigurimeve në ndërtimin e qëndrueshmërisë. Rreziqet që lidhen me këto ngjarje duhet të menaxhohen mirë nga siguruesit, duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit global të sigurimeve, me sigurues financiarisht të shëndoshë dhe policëmbajtës të mbrojtur.

Ky dokument gjithëpërfshirës do të mbështesë mbikëqyrësit në integrimin efektiv të rreziqeve që lidhen me klimën në praktikën e tyre mbikëqyrëse, duke forcuar kështu qëndrueshmërinë e sektorit global të sigurimeve.

Dokumentet e Aplikimit të IAIS nuk përfshijnë kërkesa të reja, por ofrojnë këshilla, ilustrime, rekomandime ose shembuj të praktikave të mira për mbikëqyrësit se si mund të zbatohen ICP-të. Ky Dokument Aplikimi është ndërtuar mbi Dokumentin e Aplikimit të mëparshëm, të botuar në vitin 2021 mbi rreziqet që lidhen me klimën dhe e zëvendëson atë. Ky dokument lidhet gjithashtu me mbështetjen e IAIS për përpjekjet shumëpalëshe për të ndërtuar qëndrueshmëri, duke përfshirë punën për të adresuar boshllëqet e mbrojtjes nga katastrofat natyrore.

vijon ...

Informacioni gjendet

në:

<https://www.iais.org/uploads/2025/04/Application-Paper-on-the-supervision-of-climate-related-risks-in-the-insurance-sector.pdf>

IAIS publikon Dokumentin gjithëpërfshirës të Aplikimit mbi mbikëqyrjen e rreziqeve që lidhen me klimën në sektorin e sigurimeve



Application Paper on the supervision of climate-related risks in the insurance sector

April 2025

Application Paper on the supervision of climate-related risks in the insurance sector
April 2025

Page 1 of 128

... vijon

Dokumenti i Aplikimit përshkruan praktikat e mira dhe udhëzimet për mbikëqyrësit në disa fusha, duke përfshirë:

- Rolin e mbikëqyrësve në vlerësimin e rreziqeve që lidhen me klimën;
- Integrimin e rreziqeve që lidhen me klimën në kornizat mbikëqyrëse në lidhje me qeverisjen korporative, menaxhimin e rreziqeve dhe kontrollet e brendshme;
- Ndikimin e rreziqeve që lidhen me klimën në praktikat e vlerësimit dhe investimit;
- Raportimin mbikëqyrës, zbulimin publik dhe mbikëqyrjen makroprudenciale të rreziqeve që lidhen me klimën;
- Çështjet e mbikëqyrjes së grupit; dhe
- Rolin e analizës së skenarëve të rrezikut që lidhet me klimën dhe konsideratat e rëndësishme për ndikimin e rreziqeve që lidhen me klimën në sjelljen e tregut.

Informacioni gjendet në:

<https://www.iais.org/uploads/2025/04/Application-Paper-on-the-supervision-of-climate-related-risks-in-the-insurance-sector.pdf>

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave zyrtare të publikuara në faqen e internetit të Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, tregu bullgar i sigurimeve në vitin 2024 realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 4.68 miliardë BGN, rreth 2.39 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 6.5% në krahasim me vitin e kaluar. Tregu i sigurimit të Jetës u rrit me 5.9%, duke arritur në 774 milionë BGN, ndërsa siguruesit e Jo-Jetës realizuan një rritje të primeve me 6.67% duke arritur në 3.9 miliardë BGN. Në përgjithësi, struktura e portofolit mbeti pothuajse e pandryshuar.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar me 9.8%, duke arritur në 2.08 miliardë BGN, ose afërsisht 1.06 miliardë euro. Kjo rritje është kryesisht e nxitur nga linjat e sigurimit të automjeteve të cilat patën një rritje prej 12.7%.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundvitit, të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke (CNB), tregu i sigurimeve në vend, në fund të 2024, arriti në 230.43 miliardë CZK ose rreth 9.15 miliardë euro, duke u rritur me 8.13% krahasuar me një vit më parë (i vlerësuar me monedhën kombëtare).

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 138.43 miliardë CZK ose 5.49 miliardë euro me pothuajse 27% më shumë se një vit më parë. Në dëmet e paguara, 38.5 miliardë CZK lidhen me sigurimin e pronës, të cilët patën rritjen të madhe prej 156% dhe kjo e lidhur kryesisht me dëmet e paguara pas përmbytjeve të shtatorit në Çeki.

Për tregun e Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto (përfshirë risigurimin) u rrit lehtë, me 6.6% në vit duke arritur në 57.73 miliardë CZK. Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës rritja ishte me mbi 8.64% duke arritur një vlerë të primeve të shkruara bruto në fund të 2024 në 172.7 miliardë CZK.

POLONI

www.xprimm.com

Në vitin 2024, siguruesit polakë paguan një vlerë rekord dëmsh prej 50.3 miliardë PLN ose 11.76 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 13.6% nga viti në vit. Rritje patën veçanërisht pagesat e lidhura me fatkeqësitë natyrore, me 64.1% rritje, duke arritur në 3.7 miliardë PLN ose 865 milionë euro. Kjo rritje është për shkak të përmbytjeve dhe ngjarjeve të tjera ekstreme të motit. Në të njëjtën kohë, primet e shkruara bruto u rritën me 8.9% në vit, duke arritur në 85.7 miliardë PLN.

Tregu i sigurimeve motorike grumbulloi një vlerë të primeve prej 31.4 miliardë PLN ose 7.34 miliardë euro, duke reflektuar një rritje prej 11.1%. Sfida më e madhe mbetet rritja e kostove të dëmeve, e nxitur nga shpenzimet më të larta mjekësore, çmimet e pjesëve të këmbimit dhe kostot e riparimit. Dëmet e paguara për sigurimin MTPL arritën në 12 miliardë PLN, duke u rritur në vit me +12.6%.

Vlen të përmendet se, sipas përlogaritjeve të Dhomës Polake të Sigurimeve, primi mesatar MTPL u rrit me 5.1%, duke arritur në 538 PLN. Ndërsa vlera mesatare e dëmit u rrit me 9.8% në afro 11,000 PLN.

Sigurimi i pronës pati një rritje të shpejtë, me primet e shkruara bruto që arritën në 13.1 miliardë PLN ose 3.05 miliardë euro, me një rritje prej 14% në vit. Megjithatë, viti 2024 ishte një vit sfidues për bujqësinë, me ngrica, breshër dhe përmbytje që shkaktuan dëme të mëdha. Sipas Dhomës Polake të Sigurimeve, dëmet e paguara për sigurimin e pronës arritën: 3.7 miliardë PLN për dëmet e lidhura me motin (me rritje 64.1% krahasuar me një vit më parë), 800 milionë PLN në dëmet e sigurimit bujqësor dhe 6.2 miliardë PLN në totalin e dëmeve për sigurimin e pronës (me rritje 48.6% krahasuar me një vit më parë).

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas raportit të shifrave të tregut të publikuar nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, siguruesit qipriotë raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto agregate për vitin 2024 prej 1.31 miliardë euro, me rritje 8.23% më shumë se një vit më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në linjat e sigurimit të Jo-Jetës arriti në 614.18 milionë euro me rritje me 5.64% në vit, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës gjeneroi prime prej 689.45 milionë euro, ose 10% më shumë në vit.

Gjatë vitit 2024, vlera e dëmeve bruto të shkaktuara ishte 556.55 milionë euro me rritje me 9.46% në terma vjetorë. Në vëllimin total të dëmeve, vlera prej 286.7 milionë euro lidhej me sigurimin e Jetës dhe 269.8 milionë euro me sigurimin e Jo-Jetës. Në sigurimin e Jo-Jetës, segmentet me shpenzimet më të mëdha për dëme ishin: sigurimet motorike, aksidentet dhe shëndeti dhe sigurimet nga zjarri.

RUMANI

www.xprimm.com

Në fund të vitit 2024, vlera totale e primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Rumanisë - që mbulojnë kompanitë e autorizuar dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në vend dhe degët e huaja - arritën një vlerë prej 23.4 miliardë RON ose afërsisht rreth 4.7 miliardë euro. Kjo vlerë shënon një rritje prej 11% krahasuar me një vit më parë.

Primet e sigurimit të përgjithshëm të Jo-Jetës u rritën me 10%, ndërsa sigurimet e Jetës shënuan një rritje edhe më të fortë prej 16% në fund të vitit 2024, krahasuar me vitin 2023. Segmentet më me ndikim në rritjen e vëllimit të primeve ishin klasat e sigurimit motorik (si sigurimi MTPL dhe sigurimi Kasko), sigurimet nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe sigurimet tradicionale të Jetës.

Kompanitë e sigurimeve të autorizuar dhe të mbikëqyrura nga ASF llogariten një vlerë prej 19.8 miliardë RON, ose 3.97 miliardë euro. Kjo shifër përfaqëson 84% të vëllimit total të primeve të realizuara. Ndërkohë, degët e sigurimeve që operojnë në Rumani sipas parimit të lirisë së themelimit, generuan 3.6 miliardë RON, ose 723 milionë euro prime.

Indekset e përqendrimit të tregut (CR3, CR5, CR7 dhe HHI) tregojnë një mjedis konkurrues relativisht të qëndrueshëm në segmente të ndryshme të sigurimit. Pavarësisht disa luhatjeve, tre, pesë dhe shtatë siguruesit kryesorë vazhdojnë të mbajnë një peshë dominuese në treg, duke theksuar një tendencë konsolidimi.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të tremujorit të katërt 2024, për sektorin financiar, të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, në fund të vitit 2024, tregu sllovak i sigurimeve arriti në total 2.08 miliardë euro, me rritje 7% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 3.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 781 milionë euro, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës përbënin 1.3 miliardë euro, me rritje 9.2% më shumë në krahasim me vitin 2023.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas u rrit me 11.7% në krahasim me vitin 2023 duke arritur në 1.2 miliardë euro, nga të cilat 553 milionë euro lidheshin me dëmshpërblime për Jetën, 469 milionë euro - sigurim motorik dhe rreth 74 milionë euro lidheshin me dëmet e pronës.



Për informacion
të mëtejshëm
kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al